

## UDHËZUES PËR APLIKIM PËR GRANTE PËR VULLNETARIZËM

### HYRJE

Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) dhe Community Building Mitrovica (CBM), përmes Qendrës së Burimeve të Kosovës për Shoqëri Civile (Qendra), synojnë të zhvillojnë kapacitetet e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë përmes trajnimeve të përshtatura dhe të dizajnuara në bazë të nevojave të OShC-ve, mentorimit dhe këshillimit, shërbimeve të ndihmës teknike (help desk), si dhe ndarjes së informatare të vazhdueshme për aspektet kryesore të zhvillimit organizativ dhe të qytetarisë aktive, në përgjithësi. Përveç kësaj, Qendra zbaton skemën e granteve për vullnetarizëm që ka për qëllim mbështetjen e nismave për aktivizëm qytetar dhe promovim të vullnetarizmit në vend.

Grantet për vullnetarizëm kanë për qëllim arritjen e rezultateve konkrete brenda një kornize të caktuar kohore. Përfituesit e këtyre granteve mund të jenë individët, iniciativat e paregjistruara dhe organizatat joqeveritare që prezantojnë propozimet më bindëse dhe më kreative, të cilat kanë potencial të lartë për t'i angazhuar qytetarët dhe qytetaret e Kosovës në adresimin e çështjeve të komunitetit ku ata jetojnë.

### 1. HISTORIKU

Angazhimi i qytetarëve dhe vullnetarizmi i inkurajon njerëzit të jenë më aktivë në sferën publike dhe, në të njëjtën kohë, krijon lidhje të reja midis sektorëve, komuniteteve dhe lagjeve të ndryshme.

Angazhimi vullnetar kontribuon gjithashtu në rritjen e solidaritetit dhe ndërveprimit midis njerëzve, duke krijuar kështu një mjedis më të sigurt dhe qytetarë të përkushtuar për të adresuar çështjet me interes publik, dhe në përgjithësi për të mbështetur grupet në nevojë dhe komunitetin më të gjerë<sup>1</sup>.

Kosova ka një shoqëri civile të larmishme dhe aktive që ka kontribuar vazhdimisht dhe ka një rol thelbësor në demokratizimin e vendit dhe proceset e vendimmarrjes në dy dekadat e fundit. Më konkretisht, të dhënat e anketës së qytetarëve tregojnë se 57.8% e qytetarëve të Kosovës (60.2% urbanë; 55.3% ruralë) i besojnë punës që bëjnë shoqëria civile. Megjithatë, numri i qytetarëve që janë të angazhuar dhe të përfshirë në aktivitetet e organizatave të shoqërisë civile është 5.3% (6.5% urbanë; 4.1% ruralë). Të dhënat e anketës së qytetarëve tregojnë se vetëm 3.7% e qytetarëve janë angazhuar si vullnetarë në OShC (4.18% urbanë; 3.3% ruralë) dhe 4.5% kanë mbështetur një kauzë të ngritur nga shoqëria civile (4.7% urbanë; 4.4% ruralë). Shifrat janë relativisht të ngjashme në lidhje me qytetarët që marrin pjesë në punën e OShC-ve (1.9%) ose që ofrojnë njëfarë mbështetjeje financiare për OShC-të (2.3%).

Me qëllim rritjen e potencialit për ndikim më të madh, rritjen e besimit ndërpersonal dhe kohezionin social, OShC-të duhet të bëjnë më shumë përpjekje për komunikim të rregullt dhe përfshirje të grupeve të ndryshme të qytetarëve në punën e tyre.

<sup>1</sup>Newkirk, JA, et.al., (2017), 'Vlerësimi afatmesëm i Instrumentit të Shoqërisë Civile për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë', Raporti i Vlerësimit të CSF-së, Komisioni Evropian.

Duke pasur parasysh besimin që gëzon shoqëria civile, ajo mbetet një nga mjetet më të qëndrueshme për promovimin dhe zhvillimin e një kulture të angazhimit të komunitetit dhe vullnetarizmit për çështje të së mirës publike.

#### a. Çfarë janë Grantet për Vullnetarizëm?

Grantet për vullnetarizëm kanë për qëllim iniciativat e aktivizmit qytetar dhe promovimin e vullnetarizmit në Kosovë, si dhe arritjen e rezultateve konkrete brenda një afati të caktuar kohor. Përfituesit e këtyre granteve mund të jenë organizata joqeveritare, nisma të peregjistruara dhe individë, me propozimet më bindëse dhe krijuese që kanë potencial të lartë për të angazhuar qytetarët e Kosovës në adresimin e çështjeve të komuniteteve të tyre.

### 2. PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E KËRKESAVETË THIRRJES

#### a. Kriteret e kualifikueshmërisë

Për t'u kualifikuar për aplikim, aplikantët duhet të plotësojnë kriteret në vijim:

- Të jenë individë (shtetas të Republikës së Kosovës), nisma të peregjistruara ose organizata joqeveritare aktive në Kosovë të angazhuara në ndonjë iniciativë jofitimprurëse (degët e OJQ-ve të huaja dhe ndërkombëtare të regjistruara në Kosovë nuk kanë të drejtë të aplikojnë)
- Të kenë qarkullim vjetor jo më shumë se 25.000 EUR për secilin prej tre viteve të fundit (vlen vetëm për OJQ-të);
- Të jenë drejtpërdrejt përgjegjës për menaxhimin e projektit. Partneritetet me OJQ të tjera/ nisma të peregjistruara lejohen vetëm nëse aplikanti kryesor merr përgjegjësinë e plotë për zbatimin dhe menaxhimin e projektit.
- Të demonstrojnë aftësi për menaxhimin e aktiviteteve kryesore të propozuara;
- Të mos jenë të udhëhequra ose të menaxhuara nga persona të ekspozuar politikisht.<sup>2</sup>
- Pranon dhe zotohet t'u përmbahet Vlerave Themelore për përfituesit e granteve.

#### b. Individë dhe nisma të peregjistruara

Në rastet kur aplikantët janë individë ose nisma të peregjistruara, ata duhet të dëshmojnë se angazhimi i tyre nuk është për përfitim dhe interes privat por për përfitim publik. Aplikantët gjithashtu duhet të demonstrojnë që i plotësojnë në mënyrë të duhur kriteret përkatëse të pranueshmërisë. Kur këtyre aplikantëve u jepen grante, të gjitha pagesat në lidhje me grantet do të bëhen nga KCSF-ja. Përfituesit duhet të sigurohen që të gjitha faturat pranohen në emër të KCSF-së dhe të dorëzohen në KCSF me kohë. Të gjitha kërkesat e tjera që lidhen me administrimin e granteve janë të zbatueshme sikurse për organizatat joqeveritare.

#### c. Për organizatat joqeveritare

Aplikantët duhet të demonstrojnë se angazhimi i tyre është brenda fushës së demokratizimit dhe fushave të kualifikueshme të programit. Pavarësisht statusit të tyre ligjor, jo të gjitha OJQ-të janë të përfshira në kriteret e mësipërme të kualifikueshmërisë për shkak të fushëveprimit të gjerë të legjislacionit në fuqi për regjistrimin e OJQ-ve në Kosovë. Klubet sportive, federatat sportive, shoqatat kulturore amatore apo

<sup>2</sup>Për më shumë informacion mbi kufizimet që lidhen me Personat e Ekspozuar Politikisht, shihni Modelin e Formularit të Aplikimit.

organizatat fetare që janë të regjistruara si OJQ nuk kualifikohen për grante të KCSF-së. Ngjashëm, OJQ-të që përfaqësojnë biznese ose subjekte të ngjashme me kapacitet të qartë financiar për t'i mbuluar shpenzimet e organizatës së tyre ose për t'i mbajtur aktivitetet e tyre nuk kualifikohen për grante të KCSF-së.

#### **d. Numri i aplikimeve**

Aplikantët mund të dorëzojnë vetëm një aplikacion në këtë thirrje për propozime.

#### **e. Afati kohor dhe buxheti**

Aplikantët do të kenë mundësi të aplikojnë për përkrahje për një periudhë maksimum 12 muajsh.

Buxheti maksimal i kërkuar për financim nga kjo thirrje nuk duhet të kalojë 5,000 EUR.

#### **f. Fushat e ndërhyrjes dhe popullata e synuar**

Me këtë thirrje për propozime, KCSF dhe CBM do të mbështesin nismat që kontribuojnë në mobilizimin e vullnetarëve dhe promovimin e punës vullnetare për të nxitur solidaritetin, përgjegjësinë sociale dhe qytetarinë aktive.

Më poshtë është një listë ilustruese e fushave dhe nismave që mund të financohen në kuadër të kësaj thirrjeje.

Nismat vullnetare duhet të jenë në një ose më shumë fusha ndërhyrjeje të listuara më poshtë:

- Fuqizimi i të rinjve;
- Mbrojtja e mjedisit;
- Shëndeti publik;
- Integrimi gjinor;
- Trashëgimia kulturore;
- Përfshirja sociale;

Shembuj të aktiviteteve mund të përfshijnë nisma vullnetare që:

- promovojnë vullnetarizmin dhe angazhimin e të rinjve në proceset e vendimmarrjes në komunitetet e tyre përkatëse (p.sh., propozimi i një ndryshimi politikash në qeverisjen vendore, këshillin e fshatit, këshillin e shkollës, pjesëmarrjen në konsultime në nivel lokal, ofrimin e edukimit mbi njohuritë financiare etj.);
- angazhojnë të rinjtë në aktivitete avokimi dhe mobilizimi mbi përfshirjen sociale; (p.sh., nisma avokimi që adresojnë çështjet e sigurisë publike të qytetit, fshatit ose lagjes; organizimin e diskutimeve në tryezë të rrumbullakët për planifikim buxhetor me komunën etj.)
- përfshijnë aktivitete që mobilizojnë vullnetarë në mbrojtjen e mjedisit, të dobishme për komunitetin e gjerë; (p.sh. aktivitete riciklimi, mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë natyrore, aktivitete publike për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e menaxhimit të mbeturinave, etj.)

- përfshijnë aktivitete që mobilizojnë vullnetarë për promovimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe diversitetit kulturor të komuniteteve të ndryshme që jetojnë në Kosovë; (p.sh., rritja e njohurive për trashëgiminë e përbashkët kulturore përmes vizitave në vende, promovimi i vendeve kulturore si mjet për rritjen e turizmit etj.)
- të përfshijë ligjerata dhe debate publike mbi edukimin e vajzave dhe djemve të rinj mbi shëndetin publik dhe shëndetin seksual (p.sh., qasshmërinë në produktet e higjienës, edukimin midis bashkëmoshatarëve për shëndetin riprodhues seksual, etj.);
- promovojnë barazinë gjinore, me fokus të veçantë në adresimin e stereotipeve gjinore për djemtë dhe vajzat dhe nxitjen e integritetit gjinor (p.sh. aktivitete që adresojnë luftimin e diskriminimit në të gjitha nivelet; pjesëmarrjen dhe avokimin për të promovuar buxhetimin gjinor etj.);
- përfshijnë aktivitete që mobilizojnë të rinjtë në promovimin e komunikimit dhe bashkëpunimit midis komuniteteve në Kosovë për të adresuar çështje të përbashkëta (p.sh. debate publike, punëtori, shfaqje në rrugë, shkëmbime rinore etj.);
- ripërcaktojnë hapësirat publike për të nxitur pjesëmarrjen e komunitetit, duke përfshirë ripërdorimin e hapësirave publike dhe ideve inovative për aktivitete sociale (p.sh., ridestini i hapësirave publike në lagje në mënyrë që të mund të përdoren nga komuniteti, siç janë parqet, shkollat, qendrat kulturore etj.);

**Shënim: Të gjithë këta shembuj duhet të shërbejnë si pikë orientimi në hartimin e propozimit. Kjo nuk është një kërkesë e detyrueshme për të përfshirë aktivitete specifike të listuara më sipër. Aplikantët inkurajohen të sjellin idetë e tyre origjinale në lidhje me fushat e përmendura më sipër.**

Aplikacionet duhet të përfshijnë pjesëmarrje të barabartë të vajzave dhe djemve, të adresojnë të drejtat dhe nevojat e vajzave dhe djemve të ndryshëm, personave me aftësi të kufizuara, minoriteteve rome, ashkali, egjiptiane dhe serbe, LGBTI, të moshuarve dhe të rinjve.

#### **g. Niveli i ndërhyrjes dhe mbulueshmëria gjeografike**

Përmes kësaj thirrjeje, do t'u ofrohet mbështetje nismave të shoqërisë civile në të gjithë Kosovën që synojnë të sjellin transformime në nivel lokal/komunal dhe/ose kombëtar/qendror. Në veçanti, të paktën 50 përqind e përfituesve të granteve për vullnetarizëm do të jenë organizata me seli dhe që veprojnë jashtë Prishtinës.

#### **h. Angazhimi qytetar dhe vullnetar**

Angazhimi i qytetarëve gjatë gjithë zbatimit të iniciativës së mbështetur, si dhe angazhimi vullnetar si i palëve zbatuese ashtu edhe i qytetarëve të synuar, janë elementë të rëndësishëm të kërkuar për këto grante.

Aplikantët pritët të shpjegojnë hollësisht se si synojnë të angazhojnë qytetarët, të identifikojnë dhe analizojnë qartë grupin e qytetarëve që do të synojnë dhe angazhojnë përmes këtij granti, pse angazhimi dhe pjesëmarrja e tyre janë të rëndësishme për iniciativën e tyre dhe mënyrat e ndryshme se si synojnë t'i angazhojnë ata. Duke vepruar kështu, aplikantët pritët të jenë të vetëdijshëm për ndryshimet brenda

qytetarëve të synuar (siç janë seksi, mosha, etnia, feja, arsimi, vendndodhja, rrethanat socio-ekonomike, interesat dhe nevojat) dhe të përshtasin propozimet dhe ndërhyrjet e tyre në përputhje me rrethanat.

Aplikantët duhet gjithashtu të demonstrojnë se angazhimi i tyre, si dhe angazhimi i qytetarëve të synuar dhe palëve të tjera të interesuara të bëhet në baza vullnetare. Në raste shumë specifike kur pagesa e tarifave të caktuara simbolike është absolutisht e nevojshme për arritjen e qëllimit të projektit, aplikantët duhet të justifikojnë siç duhet një domosdoshmëri të tillë.

Strategjitë e angazhimit - Aplikantët pritët gjithashtu të analizojnë potencialin e grupeve të synuara për angazhim dhe të përpunojnë një qasje realiste për rritjen graduale, por sistematike të përfshirjes së tyre në punën e organizatës.

Mbështetje e mëparshme - Nëse aplikantët janë përfitues të mbështetjes së mëparshme nga KCSF, ata duhet të japin një përmbledhje se si i kanë angazhuar qytetarët në punën e tyre deri më tani, duke theksuar progresin dhe sfidat.

Aplikantët e mbështetur do të kenë qasje në mentorim dhe ngritje të kapaciteteve mbi avokimin pjesëmarrës dhe mobilizimin e komunitetit, të cilat do të ofrojnë ndihmë në ndërtimin e përvojës së tyre të mëparshme të paraqitur dhe planit për përfshirjen e qytetarëve.

#### **i. Qeverisja e brendshme**

Qeverisja e brendshme e OJQ-së mbetet një aspekt i rëndësishëm në përpjekjet për ta përmirësuar dhe ndërtuar besimin e qytetarëve në sektorin e shoqërisë civile dhe për të qenë në gjendje që organizatat të shërbejnë si shembull.

Të gjithë aplikantët që janë OJQ pritët të japin informacion mbi mekanizmat e kontrollit të brendshëm, strukturën e menaxhimit, marrjen e vendimeve brenda organizatës dhe menaxhimin financiar. Aplikantët e përzgjedhur për t'u financuar, do të kalojnë nëpër një vlerësim fillestar të kapaciteteve nga KCSF.

Pas këtij vlerësimi fillestar, KCSF-ja do të punojë intensivisht me organizatat e mbështetura për ta zhvilluar një mentorim të përshtatur për adresimin e nevojave të identifikuara, të praktikave të qeverisjes së mirë, të menaxhimit të mirë financiar dhe të parimeve të transparencës, anti-korrupsionit dhe llogaridhënies.

#### **j. Grupet e bashkëpunimit/ rrjetëzimit**

Me qëllim nxitjen e një bashkëpunimi më të madh për veprime të përbashkëta midis përfituesve të granteve, Qendra e Burimeve të Kosovës për Shoqëri Civile do të ofrojë platforma dhe vende takimi të ndryshme ku përfituesit e granteve mund të takohen, të shkëmbejnë dhe të ndajnë përvojat me njëri-tjetrin. Organizimi dhe veprimi i përbashkët mbi çështje me interes të përbashkët do të ishte një rezultat i synuar, prandaj pritët që përfituesit e granteve të jenë proaktivë në identifikimin dhe kontributin në mundësitë për bashkëpunim me nisma të tjera vullnetare dhe të shoqërisë civile në fushat e tyre të interesit ose vendndodhjen gjeografike.

#### **k. Çështjet ndërsektoriale**

Integrimi gjinor, përgjegjësia ndaj mjedisit dhe të drejtat e njeriut do të jenë çështje ndërthurëse dhe horizontale të integruara në të gjitha ndërhyrjet. Integrimi gjinor si një mjet drejt barazisë gjinore kërkon

që të gjitha organizatat e mbështetura të sigurojnë që ndërhyrjet e tyre të marrin parasysh në mënyrë të barabartë efektet te burrat dhe gratë, djemtë dhe vajzat dhe të shmangin kontributin në stereotipe të dëmshme. Konsideratat mjedisore kërkojnë që të gjitha ndërhyrjet të kenë parasysh ndikimin e tyre në mjedis, duke promovuar qëndrueshmërinë dhe duke minimizuar efektet negative në mjedis. Parimet e të drejtave të njeriut do t'i udhëheqin të gjitha aktivitetet për të siguruar që në ato aktivitete respektohen, mbrohen dhe promovohen të drejtat dhe dinjiteti i të gjithë individëve të përfshirë, duke shmangur çdo formë diskriminimi ose padrejtësie.

### 3. KUALIFIKUESHMËRIA E AKTIVITETEVE DHE SHPENZIMEVE

#### a. Ndërhyrjet/aktivitetet jo të kualifikueshme

Ndërhyrjet/aktivitetet e mëposhtme nuk do të mbështeten:

- Aktivitetet që drejtpërdrejt lidhen me partitë politike ose që i mbështesin ato;
- Ndërhyrjet që janë të lidhura drejtpërdrejt me ose janë në mbështetje të partive politike ose kandidatëve për zgjedhje politike;
- Ndërhyrje që janë në kundërshtim me vlerat themelore për përfituesit e granteve të KCSF-së;
- Investime Kapitale;
- Grante të përbëra tërësisht ose kryesisht nga punë përgatitore dhe/ose studimet përgatitore;
- Aktivitetet dhe ndërhyrjet e projekteve ndërkufitare;
- Aktivitetet që do të zbatohen jashtë Kosovës (përveç takimeve me organizatat ose rrjetet partnere me qëllim bashkëpunimin dhe ndarjen e përvojave);
- Aktivitete të tipit të shërbimit, si ato të ngjashme me Asistencën Teknike;
- Fushatat e ndërgjegjësimit pa veprime të duhura pasuese;
- Ndërhyrjet që varen nga miratimi në shumë nivele nga palët e treta dhe që paraqesin rrezik joproporcional të lartë për dështim dhe mosarritjeje rezultatesh;
- Nëngrante për palët e treta. Mbështetja financiare në shkallë të vogël për përfituesit e punës së organizatës lejohet vetëm në rastet kur të gjitha shpenzimet kryhen nga organizata zbatuese;
- Bursat.

Në parim, aktivitetet e përshkruara më poshtë nuk do të mbështeten, përveç nëse janë të domosdoshme për arritjen e objektivave të strategjisë organizative të synuara:

- Konferenca, diskutime në tryezë të rrumbullakët ose ngjarje të tjera të ngjashme në vende (si hotele) që nuk janë të hapura dhe lehtësisht të arritshme për qytetarët e zakonshëm;
- Studime kërkimore dhe fizibiliteti, veçanërisht si një mjet për të hartuar pjesën tjetër të ndërhyrjes;
- Udhëtime studimore jashtë Kosovës.

#### b. Kostot e kualifikueshme

Për t'u konsideruar të pranueshme, shpenzimet duhet t'i plotësojnë kriteret në vijim:

- të jenë të nevojshme për zbatimin me sukses dhe arritjen e rezultateve të ndërhyrjes së treguar;
- të jenë për rimbursim të pagesave për vullnetarët e angazhuar;



- të jenë të arsyeshme, të justifikuar dhe përputhen me kërkesat e menaxhimit të shëndoshë financiar, duke përfshirë llogaritjet e drejta dhe të bazuara në treg dhe efikasitetin e kostos;
- t'i përmbushin kërkesat e legjislacionit tatimor në fuqi në Kosovë;
- të ndodhin gjatë zbatimit të grantit;;
- të tregohen në buxhetin e miratuar;
- të jenë të identifikueshme dhe të gjurmueshme.

#### **c. Kostot jo të kualifikueshme**

Shpenzimet e paraqitura më poshtë konsiderohen të papranueshme:

- Shpenzime të alokuara për burimet njerëzore (paga dhe tarifa) që tejkalojnë 10% të kërkesës totale buxhetore;
- Tarifat për ekspertët nuk lejohen, përveç nëse është absolutisht e nevojshme për të arritur qëllimin e projektit dhe e justifikuar siç duhet në formularin e aplikimit;
- Taksat doganore dhe të importit;
- Borxhi ose pagesa për humbje;
- Tatimi mbi Vlerën e Shtuar – TVSH;
- Shlyerjet e kredisë dhe interesit;
- Tarifat e këmbimit të valutave;
- Shpenzimet e amortizimit të pajisjeve;
- Blerja e tokës ose e pasurisë së paluajtshme;
- Blerja e një automjeti ose gjeneratori;
- Pagesa e shpenzimeve të mbuluara nga donatorë të tjerë;
- Kreditimi për palët e treta.

#### **4. PROCEDURA E APLIKIMIT**

Aplikantët duhet të japin infomatat e tyre, të elaborojnë idenë dhe të dorëzojnë dokumentet e nevojshme përmes [sistemit të aplikimit online](#).

Për udhëzime mbi regjistrimin dhe përdorimin e sistemit online të aplikimit, ju lutemi referojuni informacionit në dispozicion në [faqen e internetit](#) të sistemit online të aplikimit.

Nëse keni çfarëdo pyetje apo problem në lidhje me regjistrimin apo aplikimin për grant ju lutem na shkruani në [rc-kosovo@kcsfoundation.org](mailto:rc-kosovo@kcsfoundation.org)

Të gjitha pyetjet dhe përgjigjet në lidhje me aplikimin do të publikohen në seksionin Q&A (pyetje dhe përgjigje) të webfaqe të KCSF-së. Aplikantët këshillohen të kontrollojnë këtë seksion, të publikuar në webfaqe.

#### a. Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve

Aplikimet për grante për vullnetarizëm janë të hapura deri më **20 nëntor 2025, ora 23:59**

#### 5. VLERËSIMI DHE NJOFTIMI

Vlerësimi i aplikimeve për një grant projekti do të bëhet në dy faza:

- 1) Kontroll administrativ (verifikim i kriterëve formale) dhe
- 2) Vlerësimi i përmbajtjes (bazuar në kategoritë dhe kriteret e vlerësimit).

##### Kontroll administrativ (verifikim i kriterëve formale)

Të gjitha aplikacionet vlerësohen gjatë kësaj faze për të parë nëse kriteret në vijim janë respektuar/dorëzuar:

1. Të gjitha kërkesat administrative dhe teknike të paraqitura në formularin e aplikimit;
2. Dokumentet e detyrueshme, duke përfshirë edhe pranueshmërinë e organizatave;
3. Shume e kërkuar; dhe
4. Kohëzgjatja e grantit.

Aplikacionet që nuk i plotësojnë kriteret e specifikuar do të refuzohen automatikisht.

Rezultatet e përputhshmërisë me kriteret administrative i komunikohen secilit aplikant me shkrim.

#### b. Vlerësimi i aplikimeve dhe vendimi përfundimtar

Aplikacionet që e kalojnë pajtueshmërinë administrative do të vlerësohen nga ekipi për vlerësimin e granteve (EVG), i përbërë nga tre ekspertë të jashtëm me ekspertizë dhe njohuri përkatëse. EVG do t'i vlerësojë aplikacionet në dy faza, përmes: 1) shqyrtimit të dokumenteve dhe 2) intervistave publike.

Ekipi i Vlerësimit të Granteve do të vlerësojë aplikimet bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Cilësia dhe rëndësia e projektit dhe logjika e ndërhyrjes (30%)
- Angazhimi qytetar dhe angazhimi vullnetar në projekt (50%)
- Rëndësia e përvojës së mëparshme (10%)
- Efektiviteti i kostos së buxhetit të propozuar (10%)

Vlerësimi maksimal për aplikacion është 100 pikë.

Pas vlerësimit fillestar të aplikacionit të dorëzuar dhe të gjitha dokumenteve të detyrueshme, aplikantët që marrin së paku 51 pikë (nga gjithsej 100), si dhe gjysmën e pikëve në dispozicion (50%) në secilën nga pesë kategoritë e paraqitura më lart, do të përzgjidhen në listën e ngushtë.

Të gjithë aplikantët përzgjedhur në listën e ngushtë do të ftohen për intervistë publike. Intervista e aplikantëve të përzgjedhur në listën e ngushtë përbëhet nga një prezantim i shkurtër i propozimit të grantit dhe një seancë pyetje dhe përgjigje me anëtarët e ekipit për vlerësimin e granteve.



Pas përfundimit të intervistave, EVG-ja do të rekomandojë listën e aplikantëve që duhet të financohen. Për t'u marrë në konsideratë për financim, aplikantët duhet të marrin të paktën 71 pikë në total, si dhe gjysmën e pikëve të disponueshme (50%) në secilën nga katër kategoritë e paraqitura më sipër. . Përzgjedhja përfundimtare e aplikantëve të rekomanduar do të rishikohet kundrejt kuotës gjeografike, ku të paktën 50% e përfituesve do të jenë organizata me seli dhe që operojnë jashtë Prishtinës.

Donatorët kanë të drejtën e vetos për çdo aplikant në listën e rekomanduar nëse konsiderohet se bien ndesh me vlerat e promovuara nga donatori ose nëse mbivendosen me ndërhyrje të tjera të ngjashme të financuara nga donatori përkatës.

Lista e aplikantëve të rekomanduar për financim do të finalizohet vetëm pasi donatorët të kenë shteruar të drejtën e tyre të vetos, si dhe të kenë përmbushur çdo kusht eventual që mund të jetë vendosur gjatë procesit të vlerësimit paraprak.

KCSF-ja do t'i mbështesë aplikantët e suksesshëm për ta finalizuar dosjen gjatë fazës së përgatitjes së kontratës dhe fazës fillestare. Gjatë kësaj faze, duhet të plotësohen të gjitha kushtet e vendosura nga EVG-ja. KCSF-ja gjithashtu rezervon të drejtën të sugjerojë rregullime të vogla që nuk ndryshojnë aspektet themelore të aplikacionit ose aktivitetet e miratuara, por mund të përmirësojnë zbatimin me sukses të projektit.

#### **a. Njoftimi për vendimin dhe mekanizmi ankimor**

Vendimet për financim të marra nga Ekipi për Vlerësimin e Granteve dhe që nuk vihen veto nga donatorët janë përfundimtare. Pasi të përfundojë ky proces, KCSF do t'i informojë aplikantët e pasuksesshëm me rezultatet e aplikimit të tyre, duke përfshirë rezultatin total, pikët për kategori dhe renditjen përfundimtare. Informacione të mëtejshme mund të ofrohen nga KCSF vetëm me kërkesë, në formën e një përmbledhjeje të komenteve anonime nga anëtarët e Ekipit për Vlerësimin e Granteve.

Ankesa formale mund të paraqitet vetëm në rastet kur aplikantët e pasuksesshëm kanë arsye të forta për të besuar se një dokument specifik i dorëzuar nga ata është lënë jashtë procesit të vlerësimit, duke rezultuar në rezultate dukshëm më të ulëta në një kategori të caktuar ose në përgjithësi. Ankesa formale do të dorëzohet në bazë të shabllonit zyrtar të ankesës të publikuar në ueb faqen e KCSF-së.

Drejtori Ekzekutiv i KCSF-së do të themelojë një komision të brendshëm për të vlerësuar nëse lëshimi i pretenduar ka ndodhur realisht, bazuar në dëshmitë e dorëzuara nga aplikanti i pasuksesshëm dhe në informatat që mund të gjurmohen nga sistemi i vlerësimit i KCSF-së. Në rast se komisioni i brendshëm konfirmon se lëshimi ka ndodhur realisht, dokumenti i hequr do të përfshihet në dosje dhe aplikacioni do të rivlerësohet nga EVG-ja dhe rezultati i ri që rezulton nga rivlerësimi do të përfshihet në renditjen përfundimtare të aplikantëve.

Qendra e Burimeve për Shoqëri Civile në Kosovë  
Resursni Centar za Civilno Društvo na Kosovu  
Resource Centre for Civil Society in Kosovo

## 5. DATAT E RËNDËSISHME TENTATIVE

| Procesi                                                    | Datat tentative                                                                                                                                                                                                       |
|------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Lansimi i Thirrjes për Grante për Vullnetarizëm            | 23 tetor 2025                                                                                                                                                                                                         |
| Sesion/e informues/e:                                      | Detaje në <a href="http://www.kcsfoundation.org">www.kcsfoundation.org</a> ; <a href="http://www.rc-kosova.org">www.rc-kosova.org</a> ; <a href="#">Faqja e KCSF-së në FB</a> ; dhe <a href="#">Faqja e CBM në FB</a> |
| Afati i fundit për pyetje dhe sqarime                      | 11 nëntor, 2025                                                                                                                                                                                                       |
| Data e fundit për t'i publikuar përgjigjet                 | 14 nëntor, 2025                                                                                                                                                                                                       |
| <b>Data e fundit për aplikim</b>                           | <b>20 nëntor, 2025</b>                                                                                                                                                                                                |
| Informacion mbi rezultatet e kontrollit administrativ      | 24 nëntor, 2025                                                                                                                                                                                                       |
| Informata mbi aplikantët e përzgjedhur në listën e ngushtë | Nëntor, 2025                                                                                                                                                                                                          |
| Intervista publike                                         | Nëntor/Dhjetor, 2025                                                                                                                                                                                                  |
| Vendimi përfundimtar                                       | Janar, 2026                                                                                                                                                                                                           |
| Nënshkrimi i kontratave                                    | Janar, 2026                                                                                                                                                                                                           |
| <b>Fillimi i zbatimit të grantit</b>                       | <b>Shkurt, 2026</b>                                                                                                                                                                                                   |

*Ky dokument është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Suedisë. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) dhe Community Building Mitrovica (CBM) dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian ose të Suedisë.*